



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.24/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët : Violeta Husaj Rugova kryesuese, Bujar Muzaqi, dhe Hajriz Hoti, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Blerina Zogaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Fushë Kosovë, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega Fushë Kosovë, parashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkeljen e procedurës së zëvendësimit të anëtarit të Kuvendit Komunal të Fushë Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 02.04.2026, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa Anr.24/2026 datë 01.04.2026, e parashtruar nga Blerina Zogaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Fushë Kosovë, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega Fushë Kosovë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkeljen e procedurës së zëvendësimit të anëtarit të Kuvendit Komunal të Fushë Kosovë.

A r s y e t i m

-PZAP-i, ka pranuar ankesën Anr.24/2026 me datën 01.04.2026, përmes postës, nga Blerina Zogaj, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Fushë Kosovë, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, dega Fushë Kosovë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të datës 24.03.2026, me të cilin është bërë zëvendësimi i një anëtareje të Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë, duke emëruar kandidatin mashkull nga e njëjta listë, përkatësisht kandidatin me numrin më të madh të votave.

Para këtij vendimi, përbërja e Kuvendit Komunal ka qenë me gjithsej 31 anëtarë, prej të cilëve 9 kanë qenë gra, duke përbushur prapagun minimal prej 30% të përfaqësimit gjinor. Me vendimin e kontestuar, numri i grave është ulur në 8, duke e çuar përfaqësimin nën minimumin e përcaktuar me ligj, gjë që përbën shkelje të drejtpërdrejtë të parimit të kuotës gjinore.

Sipas Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligji Për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, përfaqësimi i gjinisë më pak të përfaqësuar duhet të jetë së paku 30%, dhe ky parim nuk ka të bëjë vetëm me përbërjen e listave zgjedhore, por edhe me rezultatin final në përbërjen e institucioneve përfaqësuese. Në këtë rast, zbatimi mekanik i radhitjes sipas votave ka rezultuar në cenimin e këtij parimi themelor ligjor.

Sipas parashtrueses së ankesës, në Kuvendin Komunal në Fushë Kosovë, ekzistojnë precedentë të qartë ku, në raste të ngjashme të zëvendësimit të anëtarëve është respektuar kuota gjinore, konkretisht nga subjektet politike Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, ku një anëtare femër është zëvendësuar me një tjetër femër, në vend të Rineta Berbatofci ka hyrë Saranda Sllamniku, edhe pse mund të ketë pasur kandidatë meshkuj me më shumë vota. Kjo tregon se ekziston një praktikë e konsoliduar për ruajtjen e kuotës gjinore, e cila në këtë rast është shpërfillur pa arsyetim të qëndrueshëm ligjor, duke krijuar trajtim të pabarabarta dhe jo konsistent.

Gjithashtu, thekson se vendimi i kontestuar nuk është bërë publik nga KQZ, në mënyrë zyrtare. Pala ankuese është njoftuar për ekzistencën e këtij vendimi vetëm më datë 26.03.2026, përmes publikimit të tij nga vetë kandidati i emëruar në rrjetin social Facebook.

Më tej në ankesë theksohet se këtë situatë edhe më të papranueshme e bënë fakti se KQZ, në faqen zyrtare ka publikuar vetëm dy vendime të tjera për zëvendësimin e anëtarëve të kuvendeve komunale por ka anashkaluar qëllimisht publikimin e vendimit që ka të bëjë me zëvendësimin në Fushë Kosovë. Për rrjedhojë, afati ligjor për paraqitjen e ankesës nuk mund të konsiderohet se ka filluar të rrjedhë nga data e nxjerrjes vendimit, por vetëm nga momenti kur pala ka marrë dijeni për të. Në mungesë të publikimit zyrtar dhe transparencës nga ana e KQZ-së, çdo interpretim ndryshe do të cenonte të drejtën për mjet juridik efektiv.

Duke u bazuar në të gjitha sa më sipër, konsiderojnë se vendimi i Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është në kundërshtim me dispozitat ligjore që garantojnë përfaqësimin minimal gjinor dhe si i tillë duhet të anulohet.

Prandaj, i propozojnë PZAP-it që: ta aprovojë këtë ankesë si të bazuar, ta anulojë vendimin e kontestuar të KQZ-së dhe ta obligojë KQZ-në që zëvendësimi të bëhet në atë mënyrë që ruhet kuota gjinore prej së paku 30%, përkatësisht duke emëruar kandidaten femër të radhës nga lista përkatëse.

Si provë ka bashkangjitur një fotografi, nga shpërndarjes në rrjetin social facebook.

-Në përgjigjen në ankesë KQZ-ja, sqaron se Kryesuesi i Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë, më datën 23.03.2026, Nr.07/7-446/2026, ka bërë kërkesë në KQZ për zëvendësimin e anëtares të kuvendit komunal znj.Vildane Latifi, e cila ka dhënë dorëheqje nga pozita e anëtares së kuvendit komunal.

Subjekti politik AAK, në Fushë Kosovë, në Zgjedhjet Lokale të mbajtura më 12 tetor 2025, ka fituar një (1) mandat znj. Vildane Latifi.

Bazuar në nenin 8, paragrafit në ndërlidhje me paragrafin 3, të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, përcaktohet qartazi që kuota gjinore prej 30% zbatohet brenda listave të subjekteve politike që kanë fituar mandate, me përjashtim të listave në kuadër të së cilave janë fituar dy mandate (ku ndarja bëhet në proporcion 50-50%) apo një mandat i vetëm (ku vendi i ndahet kandidatit apo kandidates më të votuar).

Të vepruarit ndryshe, sipas kërkesës së palës ankuuese, do të cenonte parimin e barazisë para ligjit, në atë mënyrë që po që se kuota për institucionin në tërësi do të përmbushej vetëm nga një apo më shumë subjekte politike, të tjerat do të përjashtoheshin nga obligimi për të pasur të paktën 30% nga kandidatët e gjinisë së nënpërfaqësuar që fitojnë vende në kuvendet komunale. Po ashtu, legjislacioni zgjedhor në Zgjedhjet Lokale nuk përcakton kuotë për kuvendin komunal si tërësi, por për listat e subjekteve, si vijon:

Në kuptim të nenit 8 paragrafi 3 i Ligjit për Zgjedhjet Lokale, vendet që i ndahen subjektit politik sipas paragrafit 1 të këtij neni, u ndahen kandidatëve që gjenden në listën e rirenditur sipas paragrafit 2 të këtij neni, duke filluar nga kandidati i parë në listën e rirenditur sipas një renditje rreptësisht zbritëse, deri në mbarimin e vendeve që i ndahen subjektit politik.

"Neni 8.4 i Ligjit për Zgjedhjet Lokale, nëse pas ndarjes së vendeve, të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të subjektit politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga një kandidat i përshtatshëm i gjinisë tjetër në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30%".

Një përcaktim i tillë është rikonfirmuar edhe nga Gjykata Kushtetuese, përmes Aktgjykimit në rastet rastet KI45/20 dhe e cila mes tjerash përcakton:

"164 „Gjykata potencoi se, ratio legis i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, në kontekst të përfaqësimit gjinor në Kuvend, konsiston në atë që siguron - në çdo rrethanë -përfaqësim prej të paktën 30% të gjinisë së nënpërfaqësuar ose gjinisë pakicë (cilado qoftë ajo). Mirëpo, qartazi, 30% paraqet vetëm kufirin minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, por jo edhe kufirin më të lartë të përfaqësimit të njërës gjini. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se, në momentin që sigurohet përfaqësimi minimal prej 30% për gjininë e nënpërfaqësuar, të gjitha zëvendësimet e ardhshme duhet të bëhen në bazë të renditjes të kandidatëve, të cilën e përcakton rezultati zgjedhor. Mbi këtë bazë, kuota gjinore zbatohet vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin është vendosur, pra, për të siguruar përfaqësimin e detyrueshëm minimal të gjinisë pakicë në kuotën prej 30%".

Në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, lidhur me formulën për ndarjen e ulëseve të Kuvendit të Komunës, si dhe numri më i vogël i kandidatëve nga gjinia e kundërt nëse

numri i kandidatëve që kanë fituar mandatë është dy (2) atëherë numri më i vogël nga të dy gjinitë duhet të jetë një (1), pra duhet të jenë një burrë dhe një grua.

Gjithashtu, edhe tek rastet kur subjekti politik ka fituar katër (4) ulëse, atëherë numri më i vogël nga të dy gjinitë duhet të jetë 2 (dy), pra duhet të jenë dy burra dhe dy gra, sepse po që se do të jetë ndryshe atëherë nuk do të arrihet përfaqësimi minimal në kuotën prej 30%" i gjinisë së kundërt.

Ndërsa, tek rastet kur subjekti politik ka fituar një (1) ulëse, zëvendësimi i anëtarit të kuvendit komunal, bëhet nga kandidati i radhës, me numër më të madh të votave nga i njëjti subjekt politik.

Sa i përket procedurës së zëvendësimit të anëtarëve të kuvendit komunal, bëhet sipas dispozitave ligjore të nenit 10 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, Udhëzimit Administrativ për Procedurën e Zëvendësimit të Anëtarëve të Kuvendit Komunal Nr.01/2017, si dhe Aktgjykimit në rastet KI45/20 dhe KI46/20, ku është përcaktuar se, pasi të jetë siguruar përfaqësimi minimal prej 30% për gjininë e nën përfaqësuar, të gjitha zëvendësimet e mëtejme bëhen në bazë të renditjes së kandidatëve, sipas rezultatit zgjedhor, Kuota gjinore, sipas këtij aktgjykimi, zbatohet vetëm deri në arritjen e qëllimit për të cilin është vendosur, përkatësisht për sigurimin e përfaqësimit minimal të detyrueshëm prej 30% për gjininë e nën përfaqësuar.

Andaj, bazuar në dispozitat ligjore të lartcekura, KQZ, më datën 24.03.2026, ka marrë vendim me Nr.01/453 /2026, për emërimin e z. Gjëlbrim Halili, anëtar të kuvendit komunal në Fushë Kosovë, nga subjekti politik AAK duke e zëvendësuar anëtarin e kuvendit komunal znj. Vildane Latifi.

PZAP-i, pasi bëri vlerësimin e pohimeve të palës ankuese, përgjigjes në ankesë dhe vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, gjeti se:

-Ankesa është e pa bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoi se bazuar në pretendimet ankimore të ankueses se ka moszbatim të dispozitave ligjore për zëvendësim sipas gjinisë, trajtimin i pabarabartë krahasuar me rastet e tjera të zëvendësimit, gjeti se ankesa është e pabazuar.

Në raport me pretendimet ankimore paneli i vlerësoi dispozitat ligjore dhe konstatoi se respektimi i kuotës nënkupton përfaqësim minimum 30% të gjinisë së kundërt dhe po që se përfaqësimi është 50%, sepse duke u bazuar në dispozitën e nenit 8 par.3 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, vendet që i ndahen subjektit politik sipas paragrafit 1 të këtij neni, u ndahen kandidatëve që gjenden në listën e rirenditur sipas par.2 të këtij neni, duke filluar nga kandidati

i parë në listën e rirenditur sipas një renditje rreptësishtë zbritëse, deri në mbarimin e vendeve që i ndahen subjektit politik.

Në Nenin 8 par.4 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, në mënyrë decisive thuhet se: *“Nëse pas ndarjes së vendeve, të përcaktuara në par.3 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të subjektit politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga një kandidat i përshtatshëm i gjinisë tjetër në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30%”. Në nenin 10 par.3, pika c të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, në mënyrë decisive thuhet se: *“nga kandidati i radhës në listën e rirenditur të kandidatëve të subjektit politik i cili ka pasur koeficientin më të lartë të votave menjëherë pas subjektit paraprak, në pajtim me formulën e përcaktuar në nenin 7.1 të këtij ligji në zgjedhjet e fundit, në rast se nuk mbetet ndonjë kandidat tjetër në listën e rirenditur të kandidatëve të partisë politike paraprake”.**

Andaj, duke u bazuar në shkresat e lëndës, pretendimet e parashtruesit të ankesës janë të pa bazuara, pasi që kandidati i zgjedhur nga subjekti politik AAK, është zgjedhur duke u bazuar në votat e marra në Zgjedhjet Lokale të mbajtura me datë 12 Tetor 2025 në Republikën e Kosovës, në kuadër të subjektit politik AAK në Komunën e Fushë Kosovës, kandidatja në listën e rirenditur, Blerina Zogaj, sipas listës së rezultateve të KQZ-së, nuk ka qenë kandidatja me numrin më të madh të votave për zëvendësim, dhe sipas rezultateve të KQZ-së, numrin më të madh të votave e ka pasur kandidati për anëtarë të kuvendit Komunal në Fushë Kosovë, Gjëlbrim Halili i cili ka zëvendësuar anëtarin e kuvendit komunal znj. Vildane Latifi.

Paneli vlerëson se për situatë të ngjashme si në rastin konkret, ka praktikë edhe nga Gjykata Kushtetuese, e cila ka vendosur me Aktgjykimet në rastet KI45/20 dhe KI46/20 me të cilin Aktgjykim është theksuar se në kontekst të përfaqësimit gjinor në Kuvend, konsiston në atë që siguron - në çdo rrethanë -përfaqësim prej të paktën 30% të gjinisë së nënpërfaqësuar ose gjinisë pakicë (cilado qoftë ajo). Mirëpo, qartazi, 30% paraqet vetëm kufirin minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, por jo edhe kufirin më të lartë të përfaqësimit të njëjës gjini dhe kjo vjenë në shprehje vetëm po që se kandidatja do të kishte fituar numin më të madhë të votave. Mbi këtë bazë, kuota gjinore zbatohet vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin është vendosur, pra, për të siguruar përfaqësimin e detyrueshëm minimal të gjinisë pakicë në kuotën prej 30%". Por në këtë rast nga subjekti politik në fjalë ka fituar vetëm një ulëse gjë që vjen në shprehje kandidati më radhë që ka fituar më shumë vota dhe nuk mund të llogaritet kuota prej 30%.

Andaj, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruar në ankesën e parashtruar, parashtruesja e ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se me këto veprime ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesja e ankesës në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e

Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke u bazuar në nenin 8 dhe 10 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA


Anr.24/2026 datë 02.04.2026

KRYESUESE E PANELIT

Violeta Husaj Rugova



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzetetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

AA.nr.18/2026

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi, kryetar i kolegjit, Qerim Ademaj dhe Milena Đerić anëtarë të kolegjit, duke vendosur sipas ankesës së ankueses: Blerina Zogaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Fushë Kosovës, nga radhët e subjektit politik: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) - Dega Fushë Kosovë, për shkak të shkeljes së procedurës së zëvendësimit të anëtarit të Kuvendit Komunal të Fushë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Anr.24/2026, të datës 02.04.2026, në seancën e mbajtur më datë 10.04.2026, merr këtë:

AKTGJYKIM

Refuzohet e pathemeltë ankesa e ankueses: Blerina Zogaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Fushë Kosovës, nga radhët e subjektit politik: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) - Dega Fushë Kosovë, ushtruar kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Anr.24/2026, të datës 02.04.2026.

Arsyetim

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Anr.24/2026, të datës 02.04.2026, është vendosur: Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.24/2026 datë 01.04.2026, e parashtruar nga Blerina Zogaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Fushë Kosovës, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega Fushë Kosovë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkeljen e procedurës së zëvendësimit të anëtarit të Kuvendit Komunal të Fushë Kosovës.



Kundër këtij vendimi, Blerina Zogaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Fushë Kosovës, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega Fushë Kosovë, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të: zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke i propozuar Gjykatës Supreme që të: I. Ndryshojë vendimin e PZAP-së, Anr.24/2026, të datës 02.04.2026, II. Të konstatojë së zëvendësimi i kandidates Vildane Latifi duhet të bëhet nga kandidatja e radhës e gjinisë femërore me më së shumti vota, përkatësisht nga Blerina Zogaj, III. Të obligojë KQZ-në që të bëjë certifikimin si anëtare të Kuvendit Komunal Fushë Kosovë.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur kundër vendimit të atakuar, i konteston në tërësi thëniet ankimore dhe i propozon Gjykatës Supreme që ankesën e datës 08.04.2026, nga ankuesja Blerina Zogaj, të paraqitur kundër vendimit të PZAP-it Anr.24/2026, të datës 02.04.2026, të refuzoj si të papabuar dhe të vërtetoj vendimin e ankimuar të PZAP.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë PZAP-i më datën 01.04.2026, ka pranuar ankesën e ushtruar nga Blerina Zogaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Fushë Kosovës, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, dega Fushë Kosovë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të datës 24.03.2026, me të cilin është bërë zëvendësimi i një anëtareje të Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë, duke emëruar kandidatin mashkull nga e njëjta listë, përkatësisht kandidatin me numrin më të madh të votave. Ankuesja në ankesë ka pretenduar se: Para këtij vendimi, përbërja e Kuvendit Komunal ka qenë me gjithsej 31 anëtarë, prej të cilëve 9 kanë qenë gra, duke përmbushur pragun minimal prej 30% të përfaqësimit gjinor. Me vendimin e kontestuar, numri i grave është ulur në 8, duke e çuar përfaqësimin nën minimumin e përcaktuar me ligj, gjë që përbën shkelje të drejtpërdrejtë të parimit të kuotës gjinore. Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, përfaqësimi i gjinisë më pak të përfaqësuar duhet të jetë së paku 30%, dhe ky parim nuk ka të bëjë vetëm me përbërjen e listave zgjedhore, por edhe me rezultatin final në përbërjen e institucioneve




përfaqësuese. Në këtë rast, zbatimi mekanik i radhitjes sipas votave ka rezultuar në cenimin e këtij parimi themelor ligjor.

Sipas parashtrimit të ankesës, në Kuvendin Komunal në Fushë Kosovë, ekzistojnë precedentë të qartë ku, në raste të ngjashme të zëvendësimit të anëtarëve, është respektuar kuota gjinore, konkretisht nga subjektet politike Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, ku një anëtare femër është zëvendësuar me një tjetër femër, në vend të Rineta Berbatofciit ka hyrë Saranda Sllamniku, edhe pse mund të ketë pasur kandidatë meshkuj me më shumë vota. Kjo tregon se ekziston një praktikë e konsoliduar për ruajtjen e kuotës gjinore, e cila në këtë rast është shpërfillur pa arsytim të qëndrueshëm ligjor, duke krijuar trajtim të pabarabartë dhe jo konsistent. Gjithashtu, theksohet se vendimi i kontestuar nuk është bërë publik nga KQZ në mënyrë zyrtare. Pala ankuese është njoftuar për ekzistencën e këtij vendimi vetëm më datë 26.03.2026, përmes publikimit të tij nga vetë kandidati i emëruar në rrjetin social Facebook.

Më tej në ankesë theksohet se këtë situatë edhe më të papranueshme e bën fakti se KQZ, në faqen zyrtare, ka publikuar vetëm dy vendime të tjera për zëvendësimin e anëtarëve të kuvendeve komunale, por ka anashkaluar qëllimisht publikimin e vendimit që ka të bëjë me zëvendësimin në Fushë Kosovë. Për rrjedhojë, afati ligjor për paraqitjen e ankesës nuk mund të konsiderohet se ka filluar të rrjedhë nga data e nxjerrjes së vendimit, por vetëm nga momenti kur pala ka marrë dijeni për të. Në mungesë të publikimit zyrtar dhe transparencës nga ana e KQZ-së, çdo interpretim ndryshe do të cenonte të drejtën për mjet juridik efektiv. Duke u bazuar në të gjitha sa më sipër, konsiderohet se vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është në kundërshtim me dispozitat ligjore që garantojnë përfaqësimin minimal gjinor dhe si i tillë duhet të anulohet.


Në përgjigjen në ankesë, KQZ-ja sqaron se Kryesuesi i Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë, më datën 23.03.2026, Nr.07/7-446/2026, ka bërë kërkesë në KQZ për zëvendësimin e anëtares së kuvendit komunal znj. Vildane Latifi, e cila ka dhënë dorëheqje nga pozita e anëtares së kuvendit komunal. Subjekti politik AAK në Fushë Kosovë, në Zgjedhjet Lokale të mbajtura më 12 tetor 2025, ka fituar një (1) mandat znj. Vildane Latifi. Bazuar në nenin 8, paragrafi 1 në ndërlidhje me paragrafin 3 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, përcaktohet qartë që kuota gjinore prej 30% zbatohet brenda listave të subjekteve politike që kanë fituar mandate, me përjashtim të listave në kuadër të së cilave janë fituar dy mandate (ku ndarja bëhet në proporcion 50-50%) apo një mandat i vetëm (ku vendi i ndahet kandidatit apo kandidatës më të votuar). Të vepruarit



ndryshe, sipas kërkesës së palës ankuese, do të cenonte parimin e barazisë para ligjit, në atë mënyrë që po që se kuota për institucionin në tërësi do të përmbushej vetëm nga një apo më shumë subjekte politike, të tjerat do të përjashtoheshin nga obligimi për të pasur të paktën 30% nga kandidatët e gjinisë së nën-përfaqësuar që fitojnë vende në kuvendet komunale. Po ashtu, legjislacioni zgjedhor në Zgjedhjet Lokale nuk përcakton kuotë për kuvendin komunal si tërësi, por për listat e subjekteve, si vijon:

Në kuptim të nenit 8 paragrafi 3 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, vendet që i ndahen subjektit politik sipas paragrafit 1 të këtij neni, u ndahen kandidatëve që gjenden në listën e rirenditur sipas paragrafit 2 të këtij neni, duke filluar nga kandidati i parë në listën e rirenditur sipas një renditjeje rreptësisht zbritëse, deri në mbarimin e vendeve që i ndahen subjektit politik. *“Neni 8.4 i Ligjit për Zgjedhjet Lokale, nëse pas ndarjes së vendeve, të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të subjektit politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga një kandidat i përshtatshëm i gjinisë tjetër në listën e rirenditur për kandidatët, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30%.”*Një përcaktim i tillë është rikonfirmuar edhe nga Gjykata Kushtetuese, përmes Aktgjykimit në rastet K145/20 dhe K146/20, e cila mes tjerash përcakton: *“Gjykata potencoi se, ratio legis i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, në kontekst të përfaqësimit gjinor në Kuvend, konsiston në atë që siguron - në çdo rrethanë - përfaqësim prej të paktën 30% të gjinisë së nënpërfaqësuar ose gjinisë pakicë (cilado qoftë ajo). Mirëpo, qartazi, 30% paraqet vetëm kufirin minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, por jo edhe kufirin më të lartë të përfaqësimit të njëres gjini. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se, në momentin që sigurohet përfaqësimi minimal prej 30% për gjininë e nënpërfaqësuar, të gjitha zëvendësimet e ardhshme duhet të bëhen në bazë të renditjes së kandidatëve, të cilën e përcakton rezultati zgjedhor. Mbi këtë bazë, kuota gjinore zbatohet vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin është vendosur, pra për të siguruar përfaqësimin e detyrueshëm minimal të gjinisë pakicë në kuotën prej 30%.”*

Në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, lidhur me formulën për ndarjen e ulëseve të Kuvendit të Komunës, nëse numri i kandidatëve që kanë fituar mandate është dy (2), atëherë numri më i vogël nga të dy gjinitë duhet të jetë një (1), pra duhet të jetë një burrë dhe një grua. Gjithashtu, edhe tek rastet kur subjekti politik ka fituar katër (4) ulëse, atëherë numri më i vogël nga të dy gjinitë duhet të jetë 2 (dy), pra duhet të jenë dy burra dhe dy gra, sepse po që se do të jetë ndryshe atëherë nuk do të arrihet përfaqësimi minimal në kuotën prej 30% të gjinisë së




kundërt. Ndërsa, tek rastet kur subjekti politik ka fituar një (1) ulëse, zëvendësimi i anëtarit të kuvendit komunal bëhet nga kandidati i radhës me numër më të madh të votave nga i njëjti subjekt politik.

Sa i përket procedurës së zëvendësimit të anëtarëve të kuvendit komunal, bëhet sipas dispozitave ligjore të nenit 10 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, Udhëzimit Administrativ për Procedurën e Zëvendësimit të Anëtarëve të Kuvendit Komunal Nr.01/2017, si dhe Aktgjykimit në rastet K145/20 dhe K146/20, ku është përcaktuar se, pasi të jetë siguruar përfaqësimi minimal prej 30% për gjininë e nënpërfaqësuar, të gjitha zëvendësimet e mëtejme bëhen në bazë të renditjes së kandidatëve, sipas rezultatit zgjedhor. Kuota gjinore, sipas këtij aktgjykimi, zbatohet vetëm deri në arritjen e qëllimit për të cilin është vendosur, përkatësisht për sigurimin e përfaqësimit minimal të detyrueshëm prej 30% për gjininë e nënpërfaqësuar. Andaj, bazuar në dispozitat ligjore të lartcekura, KQZ, më datën 24.03.2026, ka marrë vendim me Nr.01/453/2026, për emërimin e z. Gjelbrim Halili, anëtar të kuvendit komunal në Fushë Kosovë, nga subjekti politik AAK, duke e zëvendësuar anëtarin e kuvendit komunal znj. Vildane Latifi.

Pas pranimit të përgjigjes në ankesë të KQZ-së, PZAP-i, ka nxjerr vendimin Anr.24/2026, të datës 02.04.2026, me të cilën e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e kandidates ankuese, duke vendosur si në dispozitiv të vendimit të ankimuar.

Në arsyetim të vendimit ka theksuar se: PZAP-i, pasi bëri vlerësimin e pohimeve të palës ankuese, përgjigjes në ankesë dhe vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, gjeti se: Ankesa është e pabazuar. Paneli, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoi se bazuar në pretendimet ankimore të ankueses për moszbatim të dispozitave ligjore për zëvendësim sipas gjinisë dhe trajtim të pabarabartë krahasuar me rastet e tjera të zëvendësimit, ankesa është e pabazuar. Në raport me pretendimet ankimore, paneli vlerësoi dispozitat ligjore dhe konstatoi se respektimi i kuotës nënkupton përfaqësim minimum 30% të gjinisë së kundërt. Në nenin 10 paragrafi 3, pika c të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, në mënyrë decisive thuhet se zëvendësimi bëhet nga kandidati i radhës në listën e rirënditur të kandidatëve të subjektit politik, i cili ka pasur numrin më të madh të votave. Andaj, duke u bazuar në shkresat e lëndës, pretendimet e parashtrueses së ankesës janë të pabazuara,



pasi kandidati i zgjedhur nga subjekti politik AAK është zgjedhur duke u bazuar në votat e marra në Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 12 tetor 2025 në Republikën e Kosovës.

Paneli vlerëson se për situatë të ngjashme si në rastin konkret ka praktikë edhe nga Gjykata Kushtetuese. Andaj, Paneli vlerësoi se pretendimet e tilla janë të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi. Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesja e ankesës nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse. Nga arsyet e theksuara më lart, duke u bazuar në nenin 8 dhe 10 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, nenin 117 paragrafi 3 dhe nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga ankuesja dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë si dhe të gjitha shkresave të lëndës, ka konstatuar se ankesa është e pathemeltë. Gjykata çmon se vendimi i Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësja (PZAP), Anr.24/2026, i datës 02.04.2026, është nxjerrë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore që rregullojnë procedurën e zëvendësimit të anëtarëve të kuvendit komunal pas ndarjes së mandateve për Kuvendin Komunal.

Ankuesja konteston ligjshmërinë e vendimit të PZAP-it, duke pretenduar se me zëvendësimin e anëtares së Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë, Vildane Latifi, me kandidatin Xhelbrim Halili nga i njëjti subjekt politik, është cenuar parimi i përfaqësimit gjinor dhe se zëvendësimi është dashur të bëhet me kandidate të gjinisë femërore.

Gjykata, duke vlerësuar këto pretendime ankimore, i referohet dispozitave përkatëse të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale, përkatësisht nenit 8 dhe nenit 10, të cilat rregullojnë ndarjen e mandateve dhe zëvendësimin e anëtarëve të kuvendeve komunale. Sipas këtyre dispozitave, mandatet u ndahen kandidatëve sipas renditjes së tyre në listën e rirenditur, bazuar në numrin e votave të fituara, ndërsa zëvendësimi i anëtarëve bëhet nga kandidati i radhës me numrin më të madh të votave nga i njëjti subjekt politik.

Neni 8 [Shpërndarja e vendeve në Kuvendin e Komunës], paragrafët 2, 3 dhe 4 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, përcaktohet se:



Paragrafi 2: *“Të gjitha votat e fituara nga kandidatët që janë në listën e kandidatëve të çdo subjekti politik, numërohen ndaras. Listat me kandidatë rirenditen sipas mënyrës zbritëse në bazë të numrit të votave të fituara për secilin kandidat.”*

Paragrafi 3: *“Vendet që i ndahen subjektit politik sipas paragrafit 1 të këtij neni, u ndahen kandidatëve që gjenden në listën e rirenditur sipas paragrafit 2 të këtij neni, duke filluar nga kandidati i parë në listën e rirenditur sipas një renditje rreptësisht zbritëse, deri në mbarimin e vendeve që i ndahen subjektit politik.”*

Paragrafi 4: *“Nëse pas ndarjes së vendeve, të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të subjektit politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga një kandidat i përshtatshëm i gjinisë tjetër në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30%.”*

Ndërsa, neni 10 paragraf 3, [Zëvendësimi i anëtarëve të Kuvendit të Komunës], i këtij ligji përcakton se: *“KQZ-ja plotëson vendin e lirë sipas kriterëve të përcaktuara në vijim: c) nga kandidati i radhës në listën e rirenditur të kandidatëve të subjektit politik i cili ka pasur koeficientin më të lartë të votave menjëherë pas subjektit paraprak, në pajtim me formulën e përcaktuar në nenin 7.1 të këtij ligji në zgjedhjet e fundit, në rast se nuk mbetet ndonjë kandidat tjetër në listën e rirenditur të kandidatëve të partisë politike paraprake”*.

Neni 3 pika 3.7 të Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2017 për Procedurën e Zëvendësimit të Anëtarit të Kuvendit Komunal, përcaktohet se: *“KQZ-ja, bën zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal sipas radhës, mbi bazën e rezultateve të zgjedhjeve si në vijim: 3.7.1. Nga kandidati i radhës i kualifikuar, i të njëjtës gjini që gjendet në listën e rirenditur të kandidatëve të njëjtit subjekt politik dhe 3.7.2. Nëse nuk ka kandidat tjetër të të njëjtës gjini, zëvendësohet me kandidatin e radhës në listën e kandidatëve të të njëjtit subjekt politik”*

Nga shkresat e lëndës rezulton se: subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) - Dega Fushë Kosovë, ka fituar një ulëse në Kuvendin Komunal në Fushë Kosovë, ndërsa kandidatja e zgjedhur është Vildane Latifi me 399 (treqind e nëntëdhjetë e nëntë) vota. Ndërsa sipas listës së renditur nga i njëjti subjekt politik pas saj renditet: Xhelbrim Halili me 86 (tetëdhjetë e gjashtë) vota dhe pas tij ankuesja Blerina Zogaj me 71 (shtatëdhjetë e një) vota.



Mbi këtë bazë, si dhe duke pasur parasysh edhe konstatimet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në aktgjykimin KI 45/20 dhe KI 46/20, lidhur me interpretimin e nenit 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili nen përcakton se zëvendësimi i deputetëve bëhet nga *“kandidati i ligjshëm në radhë i të njëjtës gjini”*, ku citon: *“Gjykata tashmë ka theksuar se bazuar në nenet 102.3 dhe 112.1 të Kushtetutës, të gjitha gjykatat e rregullta, duke përfshirë edhe Gjykatën Supreme si instancë më të lartë gjyqësore në nivel të Republikës, kanë për obligim të interpretojnë ligjet në harmoni me Kushtetutën”*, gjykata vlerësoj se respektimi i barazisë gjinore është kriter kushtetues. (shiko: Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, rastet KI45/20 dhe KI46/20, paragraf 117 lidhur me 115 dhe 116).

Edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, me nenin 8, paragrafi 1 në ndërlidhje me paragrafin 3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale, përcaktohet qartë që kuota gjinore prej 30% zbatohet brenda listave të subjekteve politike që kanë fituar mandate, me përjashtim të listave në kuadër të së cilave janë fituar dy mandate (ku ndarja bëhet në proporcion 50-50%) apo një mandat i vetëm (ku vendi i ndahet kandidatit apo kandidates më të votuar). Gjykata vlerëson se në këtë situatë, sipas dispozitave ligjore në fuqi, mandati i takon kandidatit që ka fituar numrin më të madh të votave, pas atij të dorëhequr, pa ndonjë kufizim apo kushtëzim lidhur me përkatësinë gjinore. Edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate në këtë rast nuk është shkelur kuota gjinore andaj edhe kandidati i mandatuar me të drejtë është propozuar kandidati më i votuar sipas vullnetit të votuesve.

Gjykata thekson se dispozitat ligjore që rregullojnë përfaqësimin gjinor përcaktojnë një minimum prej 30% të përfaqësimit të gjinisë më pak të përfaqësuar, i cili zbatohet në fazën e ndarjes së mandateve brenda listave të subjekteve politike. Ky parim nuk nënkupton detyrimin që çdo zëvendësim i mëvonshëm të bëhet sipas parimit *“gjini për gjini”*. Në këtë linjë, Gjykata merr parasysh edhe praktikën e Gjykata Kushtetuese e Kosovës, sipas së cilës kuota gjinore prej 30% përfaqëson kufirin minimal të përfaqësimit dhe, pasi të arrihet ky minimum, zëvendësimet e mëtejme bëhen në përputhje me renditjen e kandidatëve sipas rezultatit zgjedhor, duke respektuar vullnetin e shprehur të votuesve.

Në kontekst të kuotës gjinore, Gjykata gjithashtu rikujton paragrafin 3 të nenit 24 të Kushtetutës i cili përcakton se: Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve



që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato, si dhe nenin 7 i cili përcakton se: Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.

2. Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.

Mbi këtë bazë, dhe në bazë të rezultatit të votave në rastin konkret rezultojnë se, kandidati zëvendësues Xhelbrim Halili ka fituar më shumë vota dhe, për rrjedhojë, është renditur para ankuses Blerina Zogaj në listën e rirenditur të subjektit politik. Kjo do të thotë se kandidati Xhelbrim Halili është kandidati i parë me më së shumti vota nga lista e subjektit politik: AAK, në kuptim të drejtpërdrejtë të dispozitave ligjore. Mos aplikimi i kriterit të zëvendësimit të të njëjtës gjini në këtë rast nuk përbën shkelje, përderisa renditja sipas votave është respektuar dhe nuk është krijuar situatë e cenimit të përfaqësimit minimal gjinor, për më tepër një frymë e tillë është në favor të respektimit të parimit të barazisë gjinore ndërmjet meshkujve dhe femrave. Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se kriteri i zëvendësimit të të njëjtës gjini nuk mund të interpretohet si mekanizëm që anashkalon automatikisht kandidatët me më shumë vota, por si mekanizëm që garanton ruajtjen e balancës gjinore vetëm atëherë kur përmes zëvendësimit do të rrezikohej kuota minimale prej 30%. Vetëm në një situatë të tillë do të justifikohesh devijimi nga renditja strikte sipas votave për të ruajtur përfaqësimin gjinor të garantuar me ligj.

Pretendimet e ankuses lidhur me praktikën e mëhershme të subjekteve të tjera politike nuk mund të merren si bazë juridike detyruese, pasi ato nuk përbëjnë burim të së drejtës dhe nuk mund të prevalojnë ndaj dispozitave të qarta kushtetuese-ligjore. Po ashtu, Gjykata vlerëson se ankuesja nuk ka paraqitur prova të mjaftueshme që do të vërtetonin se vendimi i kontestuar është marrë në kundërshtim me ligjin apo se ka pasur vërtetim të gabuar të gjendjes faktike.

Duke pasur parasysh dispozitat e lartcekura, kolegji i kësaj gjykate vlerësoi se PZAP, ka shqyrtuar të gjitha pretendimet e palës ankuese, dhe mbi bazën e jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, në rastet K145/20 dhe K146/20, drejtë ka vlerësuar se kuota gjinore prej 30% përfaqëson nivelin minimal të detyrueshëm të përfaqësimit të gjinisë së nën përfaqësuar.



Ndërsa çdo zëvendësim tjetër i kandidatëve duhet të bëhet duke ndjekur renditjen e listës dhe rezultatet zgjedhore.

Meqenëse në rastin konkret rezultojnë se kuota 30% është respektuar, ndërsa kandidati i emëruar si zëvendësim ka pasur më shumë vota se ankuesja, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, KQZ-ja dhe PZAP-ja, kanë vepruar në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës dhe nenin 3 pika 3.7 të Udhëzimit Administrativ, duke respektuar rendin e përcaktuar nga rezultatet zgjedhore. Për rrjedhojë, pretendimet e ankueses janë të pabazuara.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragraf 4, të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.18/2026, më datë 10.04.2026

Kryetar i kolegjit,

Faton Ademi



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTET
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlasćenik



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës
Oznaka spisa:

AA-18/2026

FLETËDËRGESE PËR DORËZIM PERSONAL BOSTAVNICA ZA LIČNO DOSTAVLANJE

PZAP - PRICHTINE

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dashtë të bëhet dorëzimi I sa pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtesës, fqit, personit që punon po n'atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokusajo dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestenja da radi dostavljanja bude u odredjeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena; odraslom članu domacin. Primaoca nastojniku zgrace susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno clan njenog domacinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (pribieno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____
dana _____ u _____ cas.
Shkaku i refuzimit të marrjes _____
Razlog odbijanja prijmea _____

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljava

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

ARTIGJURIM
10.04.2026

Numri i shtojcave: _____
broj priloga _____ 2

Vërtetoi se mora shkresën e lartëpërmendur
më (me fjalë)
Povrdujemo prijem gorenavegenog pisma
(i slovima)

10.04.2026

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primioca ili lica koje je
pismeno primilo u zamenu)

15:00

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljava

(Të panevojshmeve bjeri vizë - nepotrebne precrtati)

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shënuar shkaku për marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostavljač, napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.